



MINISTRIA E DREJTËSISË
Nr. 562/1 Prot.
Datë, më 29.08.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

Nr. 4425/1 prot.

Tiranë, më 28.8 2024

Lënda: Dërgim dekreti dhe ligji

MINISTRISË SË DREJTËSISË
Tiranë

Bashkëlidhur po ju dërgojmë dekretin nr.304, datë 7.8.2024, së bashku me ligjin nr.90/2024, "Për disa shtesa edhe ndryshime në ligjin nr.78/2020, "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës".

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Engjëll AGACI





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PRESIDENTI**

DEKRET

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 90/2024, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 78/2020, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës””.

Dekret nr. 304

Tiranë, më 7.8.2024

PRESIDENT I REPUBLIKËS

BAJRAM BEGAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr. 90/2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 78/2020,
“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TË PROVËS”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 78/2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Provës” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 6 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të Shërbimit të Provës dhe punonjësve administrativë në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe të degëve territoriale rregullohen sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.”.

2. Pika 6 shfuqizohet.

3. Pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. Niveli i pagave të nëpunësve të Shërbimit të Provës në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe të degëve territoriale përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me ligjin nr. 35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”.

Neni 2

Në nenin 11 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 shfuqizohet.

2. Në pikën 2 togfjalëshi “të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil” zëvendësohet me togfjalëshin “të përcaktuara në rregulloren e brendshme”.

Neni 3

Në nenin 12 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 shfuqizohet.

2. Në pikën 2 togfjalëshi “të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil” zëvendësohet me togfjalëshin “të përcaktuara në rregulloren e brendshme”.

Neni 4

Dispozitë kalimtare

Nëpunësit e Shërbimit të Provës, marrëdhëniet e punës së të cilëve aktualisht rregullohen sipas legjislacionit për nëpunësin civil, vijojnë marrëdhënien e tyre të punës sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e Punës.

Neni 5

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të nenit 1, pika 3, të këtij ligji.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren zyrtare.

Miratuar në datën 26.7.2024

KRYETARE
Lindita NIKOLLA

The image shows an official circular stamp of the President of the Council of Ministers of Albania. The stamp contains the text "KRYETARE" at the top and "Lindita NIKOLLA" in the center. Below the name is a handwritten signature. The stamp also features the coat of arms of Albania and the text "KONFERENCA E SHQIPERISE" and "KONVENDI" around the perimeter.